



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.1 dhe 12.2 shkronja d), dhe 51.2, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15 parag. 2.4, nenet 50 parag. 1.1 dhe 58.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 02 nëntor 2018, miratoi këtë,

### VENDIM

### PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

#### Neni 1

Themelohet Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – KSHMS i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- 1- Liridona Shabani, LDK
- 2- Fatlume Jaha, LDK
- 3- Vendenis Lahu, LVV
- 4- Fatmir Rudari, PDK
- 5- Tringa Sfishta, AAK
- 6- Benjamin Ejupi, PD
- 7- Avni Islami, OBKD

#### Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë Komiteti i ushtron në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës së Podujevës dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 3

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-500/01-0087376/18  
Podujevë,  
02 nëntor 2018



Kryesuesi i Kuvendit  
Fatmir Gashi